

20221251706

АГЕНЦИЈА ЗА СУПЕРВИЗИЈА НА ОСИГУРУВАЊЕ

Në bazë të neneve 235-c të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/02, 84/02, 98/02, 33/04, 88/05, 79/07, 8/ 08 , 88/08, 56/09, 67/10 dhe 44/11, 112/11, 7/12, 30/12, 45/12, 60/12, 64/12, 23/13, 188/13, 43/14, 112/14, 153/15, 192/15, 23/16, 83/18 dhe 198/18) dhe (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 101/19 dhe 31/20) dhe neni 65-b nga Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm në Transport (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 88/05, 70/06, 81/08, 47/11, 135/11, 112/14, 145/15) dhe (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 220/19), dhe në lidhje me nenin 47 paragrafi (1) të Ligjit për Kundërvajtje (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19), Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimeve në mbledhjen e mbajtur më 17.5.2022 solli

RR E G U L L O R E PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E URDHËRPAGESËS PËR KUNDËRVAJTJE

I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo Rregullore përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje.

Neni 2

1) Urdhërpagesa për kundërvajtje për autorin e kundërvajtjes shtypet në letër të bardhë në format A4 me memorandum të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

2) Forma dhe përmbajtja e urdhërpagesës për kundërvajtje jepen në shtojcë, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 3

1) Autori i kundërvajtjes për realizimin e procedurës së shlyerjes para Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimeve mund të jetë person juridik, person përgjegjës në personin juridik dhe person fizik.

2) Në rast se autori i kundërvajtjes është personi përgjegjës në personin juridik, me termin person përgjegjës në personin juridik nënkuptohet personi i autorizuar, i cili sipas ligjit dhe statutit të personit juridik në momentin e konstatimit të kundërvajtjes, përmes Procesverbalit për konstatimin e kundërvajtjes, i është besuar ushtrimi i pozitës më të lartë në personin juridik.

3) Nëse dy ose më shumë persona në personin juridik janë bartës së të njëjtës pozitë të lartë, për qëllime të procedurës së shlyerjes para Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve, personi përgjegjës është personi i parë i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 4

Për kundërvajtjet e përcaktuara me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, do të zbatohet forma dhe përmbajtja e urdhërpagesës për kundërvajtje të përcaktuar nga Ministri i Financave.

II DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 5

1) Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

2) Ditën e publikimit të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 63/20).

Nr. 01-385/1
17.5.2022
Shkup

Këshilli i Ekspertëve
Kryetari,
Крсте Шайноски, d.v.

E l a b o r i m

Qëllimi i miratimit të Rregullores së re për formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje është:

1) përcaktimi i nocionit të personit përgjegjës në personin juridik në procedurat e shlyerjes që i zbaton Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve kur kryen mbikëqyrje, si dhe

2) udhëzim për aplikimin e formës dhe përmbajtjes së urdhrimit për kundërvajtje gjatë procedurës së shlyerjes së zhvilluar nga Agjencia e Mbikëqyrjes të Sigurimeve në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.



Numër _____
Shkup, ____ . ____ . viti _____

Në përputhje me nenin 235-v të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve jep

URDHËR PËR KUNDËRVAJTJE

1. TË DHËNA PËR AUTORIN E KUNDËRVAJTJES/SHKELJES		
Emri dhe Mbiemri /Emërtimi i personit juridik:		
Numri Identifikues Tatimior/Numri Personal i Amzës së Qyetararit:		
Numri i letërnjoftimit /pasaportës /shteti:		
Adresa/selia/shtetas:		
2. TË DHËNA PËR KUNDËRVAJTJEN/SHKELJEN		
Data:	Ora:	Vendi:
Përshkrimi i shkurtër i kundërvajtjes:		
Vlera e gjobës të konfirmuar për personin juridik		
Vlera e e gjobës të konfirmuar për personin përgjegjës të personit juridik		



Vlera e gjobës të konfirmuar për personin fizik	
Procesverbal për kundërvajtjen/shkeljen e bërë:	
3.TË DHËNA PËR LLOGARINË E PAGESËS	
Pagesa e gjobave për kundërvajtjen e kryer bëhet në llogarinë e thesarit 10000000063095 - Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve- në llogarinë e pagesës 840- (komuna ku paguhet) -07342 dhe kodi i të ardhurave 722140 dhe programi 00, qëllimi i remitencave : arkëtimi i gjobës	
KËSHILLË LIGJORE : Autori/Kryerësi i cili do të paguajë gjobën brenda 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes së urdhër-pagesës për kundërvajtje, do të paguajë vetëm gjysmën e gjobës së shqiptuar. Kryerësi është i detyruar të paguajë gjobën brenda tetë ditëve nga dita e marrjes së urdhër-pagesës së kundërvajtjes dhe menjëherë të paraqesë vërtetimin e pagesës në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Nëse kryerësi nuk e paguan gjobën brenda tetë ditëve nga marrja e urdhër-pagesës për kundërvajtje, do të paraqitet kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje.	
Lidhur me urdhër-pagesën për kundërvajtje nuk lejohet ankesë.	

Autori i shkeljes

Personi i autorizuar
